

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje Shtylla Druri dhe Beton/Arme

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

KODI CPV - Shtylla Betoni 44114210-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

28 405 000 (Njezet e tete milion e katerqind e pese mije) leke pa TVSH

Ndarje ne Lote - Nuk ka

Arsyeja pse eshte marre vendim ne lidhje me mosparashikimin e ndarjes ne lote eshte bere duke patur parasysh faktin se Autoriteti Kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Shkoder po prokuron nje lloj blerje qe do te kryhet menjehere.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2020, 2021 dhe 2022 të konfirmuara me vule prane administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmes “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në tre (tre) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2023 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR-se.

Ky kriter të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas Shtojcës Nr.8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh;** ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh;** iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël".*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Gjithashtu ne lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në

Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit për të paraqitur dokumentacionin e shlyerjes së taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë të vertetojnë se ushtrojnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën e kërkuar që është brenda vlerës së përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet .

Ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

2.3.2 Dokumentacioni

Per mallrat objekt prokurimi – Shtylla beton arme dhe druri

Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

1. Operatori Ekonomik duhet te paraqese autorizim te prodhuesit / distributorit per mallin e kerkuar. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Ne rast te disponimit te autorizimit te prodhuesit ne gjuhe te huaj, ky dokument te paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar ne gjuhen zyrtare shqipe.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, Operatori Ekonomik duhet te paraqese: Katalogun/et ose fragmente te katalogut /eve te prodhuesit/ve per mallrat objekt prokurimi ku te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen. *Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.*

Argumentim: Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, eshte vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3. Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi te testimave zyrtare te kryera per mallrat objekt prokurimi te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi, qe vertetojne pajtueshmerine e mallrave te prodhuara (lista e mësipërme e mallrave) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kriteret e kualifikimit vendosen qe ti sherbejne AK-se, per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te OE-ve, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme si aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur si dhe cdo element tjeter ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne permbushje te kriterit te mesiperm, Operatoret Ekonomike, duhet te paraqesin deshmi te testimave zyrtare te kryera, leshuar nga institucione te autorizuar, ose nga prodhuesi, per mallrat e cituar me siper, per te krijuar bindjen se malli i ofruar eshte brenda parametrave te kerkuara. Eshte ne te drejten e AK te kerkoje deshmi per rezultatet e testimave zyrtare qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike te vendosura, perpara se AK te beje perzgjedhjen e OE-se fituese. Kjo kerkese eshte ne perputhje me piken 6/c, te nenit 40 te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik".

4. Operatori Ekonomik duhet te paraqese certifikate te vlefshme qe verteton se sistemi i kontrollit dhe menaxhimit te cilesise se tij eshte ne perputhje me ISO 9001 - 2015 dhe objekti i saj te perputhet me mallrat e kerkuara. Ne rast bashkimi te operatoreve ekonomike, secili anetar duhet te paraqese certifikatat ISO te sipercituara.

Argumentimi: Ne lidhje me kërkesën qe OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikaten e standarteve ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me te, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata per sistemin e menaxhimit te cilesise ISO 9001 eshte e nevojshme si kriter kualifikues pasi lidhet me natyren dhe vleren e kontrates, me qellim per te vertetuar dhe te garantoje realizimin ne kohe, me sukses dhe me cilesi sipas standarteve nderkombetare te objektit te kontrates. Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", dhe nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

5. Operatori Ekonomik duhet te paraqese vetedeklarim qe deklaron se sistemi i menaxhimit te cilesise te prodhuesit / ve eshte sipas standartit ISO 9001 - 2015 dhe objekti i saj te perputhet me mallrat e kerkuara.

Argumentimi: Ky kriter eshte kerkuar pasi vetem prodhuesi mund te vertetoje se produktet e prodhuara kanë në fakt, karakteristikat e deklaruara. Certifikata e sigurimit të cilësisë ka për qëllim të plotësojë deklaratën fillestare apo certifikatën e përshtatshmërisë. Si provë që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar cilësinë e produktit, prodhuesi pajiset me certifikatën për cilësinë e sistemit të kontrollit i cili monitoron fabrikimin e produkteve të caktuara. Këto certifikata bazohen në standardet ndërkombëtare ISO 9001: 2000.

6. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë konformiteti ku të shprehet që materialet të kenë markim CE.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e deklaratës së konformitetit për produktet që kërkohen me sipër, është një kërkesë e lidhur ngushtësisht me objektin e kontratës dhe duke qenë se, Autoriteti Kontraktor është përfitues direkt i kontratës objekt prokurimi është në të drejtën e tij të garantohet se OE-të pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e çelësive të mallit që do të ofertohej, rrjedhimisht është e drejtë e AK-së të kërkojë ofertuesve që të paraqesin deklaratë për të vertetuar konformitetin prodhimit të produkteve të procedurës së prokurimit. Për Autoritetin Kontraktor është e nevojshme që, Operatorët ekonomikë gjatë ofertimit të tyre të provojnë se zotërojnë kapacitetet teknike lidhur me deklaratën e konformitetit për artikujt e kërkuara me sipër. Kërkesa e mesipërme ka si qëllim të sigurojë AK-në, mbi aftësitë teknike të OE fitues në drejtim të përmbushjes me sukses të kontratës dhe detyrimeve në zbatim të saj, konform standarteve të mirepërcaktuara në DST. Ky kriter nuk është diskriminues dhe është proporcional me objektin e kontratës, si dhe është në zbatim të Nenit 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

7. Në funksion të plotësimit të Shtojcës 8 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemër, Ateshi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin / Administratorët e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Për këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, ateshi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

- *Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.*
- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.

- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **Data 21.08.2023 Ora 10.00 vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .**

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.